



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 875 prot.

Tiranë, më 07.06.2022

V E N D I M

Nr. 104, Datë 07.062022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.215 Regj, datë 17.11.2021, paraqitur nga ankuesja K.F, kundër Ministrisë së Mbrojtjes¹, me pretendimin për diskriminim për shkak të *gjendjes ekonomike*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, ankuesja K.F parashtron se është diplomuar nga Universiteti i Mjekësisë, Dega Mjekësi e Përgjithshme, në datën 30.07.2019 dhe është licensuar nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë në datën 27.01.2020. Në korrik 2020, ankuesja deklaroi se ka fituar të drejtën për të vazhduar specializimet afatgjata në Degën Kirurgji Plastike, Rekonstruktive dhe Estetike, me kuotë të mbuluar nga Ministria e Mbrojtjes, me të cilën ka firmosur kontratën në datën 24.07.2020.

Ankuesja shpjegon se, në pikën 3, të nenit 4, Kontrata përcaktonte se, Ministria e Mbrojtjes nuk garantonte asnjë lloj trajtimi financiar për personat që nuk vinin nga radhët e Forcave të Armatosura, sikurse është ajo. Ankuesja shprehet se e ka firmosur kontratën e gjendur në kushtet që ky specializim është shumë i rëndësishëm për jetën dhe karrierën e saj profesionale. Pas 1 viti në këtë marrëdhënie kontraktore, ankuesja shprehet se një trajtim i tillë është i padrejtë dhe diskriminues.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën MM.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ankuesja shprehet se, kontrata e saj e punës, siç përcaktohet nga neni 2 i saj, rregullohet nga Rregullorja e Studimeve Afatgjata, të Ciklit të Tretë, në Fushën e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, miratuar me vendimin nr.88, datë 16.11.2016, të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, i ndryshuar. Sipas ankueses, ky akt përcakton se të gjithë specialistët kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime, por trajtimi financiar bëhet nga secili institucion që ka kërkuar kuotat e specializimeve.

Ankuesja pretendon se, të gjithë specialistët bëjnë të njëjtën punë, por ndërsa disa specialistë që kanë lidhur kontrata me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, trajtohen financiarisht, ajo nuk e përfiton trajtimin financiar. Specializimi është një lloj forme trajnimi në punë, ku specialistët kryejnë të gjitha proceset e punës që kryejnë mjekët dhe infermierët në çdo vend të Bashkimit Evropian. Në Republikën e Shqipërisë specialistët trajtohen financiarisht, pasi nuk është normale, që një person që ka përfunduar studimet e larta për mjekësi dhe shërben pranë një strukture spitalore, të mos paguhet.

Sipas ankueses, një trajtim i tillë, jo vetëm diskriminon studentët kundrejt njëri-tjetrit, por haptazi diskriminon studentët që vijnë nga familje që nuk kanë shumë mjete financiare në dispozicion, pra që janë të varfër kundrejt atyre që janë të pasur, pasi presupozon që një person në moshën 25 vjeçare të jetë akoma barrë dhe përgjegjësi për prindërit apo të afërmit dhe qartazi ata njerëz nuk e kanë këtë mundësi, nuk mund të specializohen, pasi nuk kanë si të ushqehen.

Përfundimisht, ankuesja kërkon nga Komisioneri që të marrë masa për të rregulluar situatën dhe për të ndrequr këtë padrejtësi.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar³, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminim garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën LMD.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1566/2 prot, datë 06.12.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga MM, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Me shkresën nr.5854/1 prot., datë 10.12.2021⁴, MM ka kthyer përgjigje në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë, duke parashtruar ndër të tjera se:

Znj. K.F. nëpërmjet urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr.859, datë 23.07.2020 është miratuar për të ndjekur studimet pasuniversitare afatgjata mjekësore në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës, në specialitetin *“kirurgji plastike”*. Në bazë të vendimit nr.8, datë 03.02.2020 dhe nr.37, datë 28.04.2020, të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë Tiranë *“Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në programet e specializimit afatgjata, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2019-2020”*, Ministrisë së Mbrojtjes, në bazë të nevojave të paraqitura, iu akorduan 20 kuota, prej të cilave 15 u plotësuan me personel civil, jashtë radhëve të FARSH, një me personel civil që shërben në strukturat e FARSH dhe një kuotë me personel ushtarak që shërben në strukturat e FARSH.

Në momentin e aplikimit për kuotat e mbuluara nga Ministria e Mbrojtjes, të gjithë aplikantët kanë qenë në dijeni të faktit se para fillimit të studimeve duhet të nënshkruanin një kontratë me Ministrinë e Mbrojtjes, në të cilën përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve. Kontrata është miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr.856, datë 23.07.2020 *“Për miratimin e kontratës “Për ndjekjen e studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë nga personeli ushtarak dhe civil i Forcave të Armatosura dhe civilët jashtë radhëve të Forcave të Armatosura”*. Në modelin 3, të kontratës *“Për ndjekjen e studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë nga civilët jashtë radhëve të forcave të armatosura, të cilët kanë marrë mbështetjen për të aplikuar nga kuotat e Ministrisë së Mbrojtjes”*, neni 4, pika 3, përcaktohet se: *“Ministria e Mbrojtjes nuk garanton asnjë lloj trajtimi financiar për studentët jashtë radhëve të forcave të armatosura, të cilët do të ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë, për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes”*. Gjithashtu, në nenin 4, pika 5 të kontratës, përcaktohet : *“Ministria e Mbrojtjes, pas përfundimit të specializimit, u krijon studentëve mundësinë e punësimit në strukturat shëndetësore të FA-së, në varësi të nevojave të FA-së dhe specializimin përkatës të kryer”*.

Për sa i përket personelit ushtarak dhe civil mjek, të punësuar pranë strukturave të MM dhe FARSH, Ministria e Mbrojtjes garanton trajtimin financiar sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht:

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1566/3 prot., datë 14.12.2021.

- Personeli ushtarak mjek trajtohet sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr.9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Personeli civil mjek që shërben në strukturat e FARSH trajtohet sipas pikës 11, të VKM nr.555, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosur”, i ndryshuar.

Si përfundim e gjithë procedura është bërë transparente dhe se znj. K.F e ka firmosur kontratën model nr.3, me dëshirën e plotë të saj, pa asnjë kundërshtim dhe ka filluar studimet pasuniversitare në degën “kirurgji plastike”.

2. Në datën 13.01.2022, ankuesja ka depozituar në rrugë elektronike (me e-mail) kundërshtimet e saj në lidhje me përgjigjen e MM, duke parashtruar, ndër të tjera se:

Një mjek specializant kryen gjithë detyrat që kryejnë mjekët e tjerë dhe i vetmi ndryshim është se këto përmbushen nën mbikëqyrjen e një mjeku të specializuar, por nuk ka asnjë lloj ndryshimi, si intensiteti i punës, si cilësia e e shërbimit që ofrohet, në raport me mjekët e tjerë rezidentë në spital. Gjatë specializimit, mjekët specializantë, ushtrojnë shërbimin e rojes, ku gjithë pacientët janë nën përgjegjësinë mjekësore dhe penale të mjekëve specializantë. Ankuesja pretendon se nuk është e arsyeshme që kolegë si ajo, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të paguhen kurse ajo jo.

Për pretendimet e Ministrisë së Mbrojtjes, se kontrata është firmosur me vullnetin e lirë nga ankuesja, ajo shprehet se, është një paraqitje e pasaktë e rrethanave, pasi ajo ishte në kushtet ku nuk mund të negocionte dhe nuk iu dha asnjë alternativë. Ajo është detyruar të nënshkruajë kontratën, pasi në të kundërt do të humbiste të drejtën e specializimit. Ankuesja thekson se, Ministria e Mbrojtjes duhet të kishte marrë të gjitha masat organizative për të mos lejuar Shtabin e Përgjithshëm të FA të prodhonte një kontratë abuzive, ku shkelen dispozitat më elementare të Kodit të Punës dhe Kodit të Procedurave Administrative. Nuk mund të ketë punë pa pagesë dhe dihet botërisht se specializantët paguhen.

3. Me shkresën nr.1566/4 prot., datë 15.12.2021, Komisioneri kërkoi informacion shtesë nga Ministria e Mbrojtjes, në lidhje me arsyet e diferencës në trajtim midis studentëve që ndjekin studimet afatgjata në fushën e mjekësisë që vijnë nga radhët e civilëve dhe atyre që vijnë nga radhët e Forcave të Armatosura. Në vijim të kësaj kërkese, me shkresën nr. 4166/1 prot datë 06.01.2022, ka kthyer përgjigje Akademia e Forcave të Armatosura, por informacioni i dërguar nuk adresonte çështjet e kërkuara nga Komisioneri në kërkesën e tij për informacion drejtuar MM.

4. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: “ 8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri në datën 09.02.2022, zhvilloi një seancë dëgjimore publike.

Në seancë dëgjimore ankuesja u përfaqësuar nga Av. J.K, me Nr.License 10258, në bazë të prokurës së posaçme nr.1169 rep dhe nr.787 kol, datë 09.02.2022, hartuar nga notere Shpresa Gjoci.

Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë të MM, e cila kishte rregullisht dijeni, sipas lajmërim marrjes së shërbimit postar, por nuk u paraqit dhe nuk paraqiti asnjë shkak për mosparaqitjen e saj.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 300/5 prot., datë 11.02.2022, Komisioneri kërkoi informacion nga Ministria e Mbrojtjes, në lidhje me faktin nëse janë trajtuar financiarisht studentët të cilët ndjekin specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, të cilën nuk vijnë nga radhët e forcave të armatosura, para vitit 2020. Me shkresën nr. 799/2 prot., datë 24.02.2022, MM, ktheu përgjigje, duke informuar ndër të tjera, si më poshtë:

Përpara vitit 2020, të gjithë studentët të cilët kanë ndjekur specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, duke përfituar nga kuotat e mbuluara nga MM, kanë qenë personel mjek (civil dhe ushtarak), pjesë e strukturave të MM, Forcave të Armatosura (FA) të RSH-së dhe strukturave vartëse. Znj. K.F, nëpërmjet urdhrin të MM nr.859, datë 23.07.2020, është miratuar për të ndjekur studimet pasuniversitare afatgjata mjekësore, në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës, në specialitetin “kirurgji plastike” si personel civil, jashtë radhëve të FARSH.

6. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri kërkoi informacion në lidhje me trajtimin financiar të specializantëve, nga ana e institucioneve të cilat në bazë të vendimit nr. 8, datë 03.02.2020 dhe nr.37, datë 28.04.2020, të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë Tiranë “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në programet e specializimit afatgjata, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2019-2020” mbulojnë kuota të caktuara të pranimit në specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin respektiv akademik. Konkretisht, Komisioneri kërkoi informacion nga institucionet e mëposhtme:

6.1 Me shkresën nr.300/1 prot datë 11.02.2022 dhe nr.486 prot., datë 23.03.2022, Komisioneri kërkoi informacion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes (MSHMS). Me shkresën nr.774/2 prot., datë 28.03.2022, MSHMS, ktheu përgjigje duke informuar se:

Trajtimi financiar i studentëve të cilët vazhdojnë specializimet afatgjata nga kuotat e MSHMS dhe masa e përfitimit të tyre, parashikohet në aktin nënligjor VKM nr.555, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore

Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të armatosura”, e konkretisht pika 11, ku përcaktohet: “11. Mjekët e sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe mjekët civilë të strukturave të Forcave të Armatosura, të cilët kryejnë specializimin në qendrat spitalore universitare, gjatë kohës së specializimit, të paguhen në masën 80 përqind të pagës së mjekut të fushës në të cilën kryhet specializimi.”

Në lidhje me vitin akademik 2019-2020, pika 21, të udhëzimit nr.2, datë 03.02.2020 “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2018-2020”, të Rektorit të UMT-së, janë lidhur marrëdhëniet kontraktuale financiare për specializantët që kanë përfituar nga kuotat e mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë.

Me vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, miratohet çdo vit akademik shpërndarja e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të propozuara nga ministrinë përkatëse. Gjithashtu, në vendimin/et e/të Senatit Akademik përcaktohet se, modelet e kontratave, modalitetet e lidhjes së saj, penalitetet në rast mosrespektimi të tyre janë përgjegjësi e ministrive përkatëse.

Në kuadër të kësaj, MSHMS, miraton kontratën për çdo vit akademik, pasi ajo bazohet në vendimin e senatit për vitin akademik përkatës, për shkak të specifikës së tij, që lidhet me miratimin e shpërndarjes së kuotave për vit akademik. MSHMS, informon në përgjigjen e saj se, në çdo kontratë, parashikohet klauzola e trajtimit financiar për studentët që përfitojnë nga kuotat e kësaj ministrie, në masën sipas legjislacionit në fuqi, pika 11, e VKM nr.555, datë 11.08.2011.

6.2 Me shkresën nr. 545 prot., datë 31.03.2022, Komisioneri kërkoi nga MSHMS, informacion në lidhje me faktin nëse, ka studentë të cilët vazhdojnë specializimet afatgjata me kuota të MSHMS, të cilët nuk janë mjekë në sistemin e kësaj ministrie dhe nëse ata trajtohen financiarisht prej këtij institucioni. Me shkresën nr.774/4 prot., datë 20.04.2022, MSHMS, bëri me dije se:

MSHMS, bazuar në planifikimin që bën Fakulteti i Mjekësisë për kuotat e specializimeve, propozon tek Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë Tiranë kuotat e specializimeve afatgjata të ciklit të tretë të studimeve në fushën e mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, në programe studimi/degë të ndryshme për nevojat e saj. Trajtimi financiar bëhet sipas pikës 11, të VKM nr.555, datë 11.08.2021. Specializimet afatgjata të ciklit të tretë të studimeve në fushën e mjekësisë në Universitetin e Tiranës janë me shkëputje nga puna.

MSHMS trajton si më sipër vetëm mjekët specializantë që lidhin kontratë me këtë ministri.

6.3 Me shkresën nr.300/2 prot datë 11.02.2022, Komisioneri kërkoi informacion nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT). Me shkresën nr.659/3 prot., datë 01.03.2022, QSUNT, ktheu përgjigje duke informuar se:

QSUNT kryen pagesën për mjekët specializantë (kuotë e mbuluar me MSHMS, ku janë miratuar 308 kuota), marrëdhënia me të cilët rregullohet në zbatim të kontratës për ndjekjen e specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë pranë Universitetit të Mjekësisë, të nënshkruar ndërmjet kësaj kategorie specializantësh dhe MSHMS, pika c, sipas të cilës: "Të garantojë trajtimin financiar të mjekut/mjekes nëpërmjet Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor gjatë periudhës së studimeve në masën 80 % të pagës së mjekut", si dhe sipas VKM nr.555, datë 11.08.2011, të ndryshuar, neni 11. Referuar mjekëve specializantë, të cilët nuk janë kuotë e mbuluar nga MSHMS, QSUNT nuk ka asnjë kontratë nga e cila mund të lindë e drejta për trajtim financiar të tyre.

Referuar rregullores së Studimeve të Specializimeve Afatgjata, të Ciklit të Tretë, në fushën e Mjekësisë në Universitetin e Tiranës, miratuar me vendimin nr.88, datë 16.11.2016, të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, të ndryshuar, në nenin 51 (faqe 36) citohet: *".....Sektori i fakultetit përkatës mban në formën e shkruar dhe të informatizuar, një pasqyrë të përvitshme për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programet specializuese afatgjata, tërheqjet nga programi i studimi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik...."*

6.4 Me shkresën nr.300 prot datë 11.02.2022 dhe nr. 300/11 prot., datë 31.03.2022, Komisioneri kërkoi informacion nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë (UMT). Me shkresën nr.397/5 prot., datë 11.04.2022, UMT, ktheu përgjigje duke informuar se:

UMT, si institucion publik i arsimit të lartë i ushtron funksionet dhe kompetencat e tij në zbatim të ligjit nr.80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, Statutit të UMT, Rregullores së Studimeve Afatgjata, të Ciklit të Tretë, në Fushën e Mjekësisë, në UMT dhe akteve të tjera nënligjore.

Për rastin konkret, studimet e ciklit të tretë "Specializime Afatgjata në Fushën e Mjekësisë" dhe për kuotat e mbuluara apo të dedikuara të ministrive përkatëse, UMT-ja, si për të gjitha kuotat dhe studentët specializantë ofron vetëm procesin mësimor, kërkimor e shkencor, ndërsa marrëdhëniet e tjera juridike, studentët i kanë individuale me ministrinë përkatëse, sipas kuotave që ato mbulojnë, ndaj UMT-ja nuk disponon informacion mbi aktin ligjor apo nënligjor që ministria mund të trajtojë financiarisht studentët specializantë që janë regjistruar dhe vijojnë studimet në një kuotë të dedikuar një ministrie.

Për marrëdhëniet që studentët specializantë kanë me UMT, gjatë kryerjes së studimeve të tyre kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime, përcaktuar këto në aktet ligjore dhe nënligjore cituar më sipër.

UMT shprehet se nuk mund të japë një përgjigje nëse, studentët specializantë kanë të drejtë të trajtohen financiarisht, pavarësisht faktit nëse janë pranuar nga kuotat e ministrisë apo nga kuotat

e lira dhe cili është institucioni përgjegjës për të mbuluar trajtimin e tyre financiar, pasi UMT ofron vetëm procesin mësimor, kërkimor e shkencor dhe për këtë, të gjithë studentët specializantë paguajnë për llogari të universitetit tarifën e regjistrimit dhe tarifën e studimit, marrëdhënie kjo e rregulluar në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në UMT.

Për UMT, midis studentëve specializantë që janë regjistruar dhe ndjekin studimet e tyre, si në kuotat e lira dhe në ato të dedikuara për ministrinë përkatëse, nuk ka asnjë ndryshim, përveç faktit se kur kandidatët aplikojnë për të konkuruar për specializimin afatgjatë, përcaktojnë kuotën se ku aplikojnë, në kuotë të lirë, kuotë të mbuluar nga MSHMS, Ministria e Drejtësisë, MM apo Ministria e Brendshme, bazuar në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në UMT.

Për UMT, midis studentëve specializantë që janë regjistruar dhe ndjekin studimet e tyre si në kuotat e dedikuara për ministrinë përkatëse, si nga ana akademike dhe ajo financiare (tarifa e regjistrimit dhe tarifa e shkollimit) nuk ka asnjë ndryshim.

6.5 Me shkresën nr.300/4 prot datë 11.02.2022, Komisioneri kërkoi informacion nga Ministria e Drejtësisë (MD). Me shkresën nr.896/2 prot., datë 15.03.2022, MD, ktheu përgjigje duke informuar se:

Për vitin akademik 2017-2018, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) ka lidhur kontratat me mjekë specializantë të pranuar në fushën e mjekësisë në programin e studimit të ciklit të tretë në UMT, për ndjekjen e specializimit për periudhën 14.05.2018 deri në 14.05.2022, referuar vendimit të Senatit nr.14, datë 31.01.2018 *“Për kuotat e pranimit dhe tarifën e shkollimit në programet e specializantëve aftagjatë të ciklit të tretë të studimeve në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2017-2018”*.

Referuar kontratave të lidhura, mjekët specializantë duhet të trajtoheshin financiarisht me 80 % të pagës së mjekut specialist të fushës, sipas pikës “c”, të nenit 5 të kontratës së lidhur me DPB. DPB i refuzoi pagesat e specializantëve pasi me ligjin e buxhetit të vitit 2018, nuk ka patur të miratuar numër punonjësish shtesë mbi numrin e strukturave të miratuara.

MD i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) numër punonjësish shtesë me kontratë për mjekët specializantë të DPB, që të përfshiheshin si punonjës me kontratë të përkohshme, por MFE është shprehur se, inicimi i një VKM-je për përfshirjen e mjekëve specializantë në punonjës me kontratë të përkohshëm pune nuk ka asnjë ngjashmëri me aktivitetin e mjekëve specializantë, për t'i trajtuar ata si punonjës me kontratë të përkohshme për gjithë vitin buxhetor.

Ndërsa për vitin akademik 2021-2022, referuar vendimit të Senatit nr.23, datë 26.02.2021, *“Për kuotat e pranimit dhe tarifën e shkollimit në programet e specializantëve afatgjatë të ciklit të tretë të studimeve në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2020-2021”*, DPB ka lidhur kontrata

me mjekë specializantë të pranuar në fushën e mjekësisë në programin e studimit të ciklit të tretë në UMT, për ndjekjen e specializimit për periudhën 10.05.2021 deri në 10.05.2025 pa trajtim financiar.

6.6 Me shkresën nr.300/3 prot datë 11.02.2022 dhe nr. 545/1 prot., datë 31.03.2022, Komisioneri kërkoi informacion nga Ministria e Brendshme (MB). Me shkresën nr.1680/4 prot., datë 11.04.2022, UMT, ktheu përgjigje duke informuar se:

Referuar kuadrin trajtues mbi specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë në UMT, studentëve që përfitojnë nga kuotat e parashikuara dhe të mbuluara nga MB, u lëshohet një letër mbështetje nga Ministri i Brendshëm. Midis kandidatit fitues (i mbështetur) dhe Ministrit të Brendshëm lidhet një kontratë, në të cilën përcaktohen detyrimet mes palëve si dhe penalitetet, në rastet e mosrespektimit të kontratës.

MB, informon në përgjigjen e saj se, kjo ministri ka patur vetëm 1 (një) kuotë specializimi afatgjatë në fushën e mjekësisë, në programin e studimit “Neurologji”, në UMT, për të cilin është lidhur kontrata me nr.5468 prot., datë 24.07.2020, për periudhën 20.07.2020 deri më 30.07.2024. Rezulton se nuk është kryer asnjë pagesë specializantit me të cilin është lidhur kontrata. Në nenin 5 të kontratës, është parashikuar se, gjatë periudhës së studimeve MB, nuk garanton trajtimin financiar të specializantit, për shpenzime që rrjedhin nga ndjekja e specializimit. Në buxhetin e viteve 2021-2024 nuk janë parashikuar mjete financiare për mbulimin e kuotës për specializantën.

MB informon se, bazuar në informacionin e disponuar prej tyre, nuk ka patur asnjë specializant afatgjatë në fushën e mjekësisë, të cilët të kenë përfutur nga kuotat e MB dhe të jenë trajtuar financiarisht nga ana e tyre.

7. Në vijim të seancës dëgjimore, me email datë 17.03.2022, ankuesja ka dërguar parashtrime shitesë dhe dy formate kontratash (modele) të cilat parashikojnë trajtim financiar për studentë të cilët janë personel civil dhe personel civil në FA, të cilët ndjekin specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, me kuota të mbuluara nga MM.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës, rezulton se bazuar në urdhrin nr.859, datë 23.07.2020 “ *Për miratimin e personelit civil që do të ndjekë specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, në vitin akademik 2019-2020*”, të Ministrit të Mbrojtjes, ankuesja K.F është miratuar për të ndjekur specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë në UMT, në specialitetin “kirurgji plastike”.

Ankuesja ka nënshkruar me Komandantin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kontratën me nr.1855/8 prot., datë 24.7.2020 “Për ndjekjen e programit të ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë nga civilët jashtë radhëve të forcave të armatosura, të cilët kanë marrë mbështetjen për të aplikuar nga kuotat e Ministrisë së Mbrojtjes”. Në pikën 3, të nenit 4, të kontratës përcaktohet : “Ministria e Mbrojtjes nuk garanton asnjë lloj trajtimi financiar për studentët jashtë radhëve të FA-së, të cilët do të ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë, për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes”

Pas 1 (një) viti në këtë marrëdhënie kontraktore, ankuesja konstaton si të padrejtë faktin që MM nuk garanton asnjë lloj trajtimi financiar për studentët specializantë jashtë radhëve të FA, të mbështetur me kuota nga kjo ministri, sikurse është ajo vetë.

Sa më sipër, ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar nga ana e MM.

Referuar nenit 3, pika 1, të LMD, “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, i ndryshuar, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesja është trajtuar në mënyrë të diferencuar dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen.
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët (person ose grup personash) në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një shkak/ose më shumë, që gëzon mbrojtje nga ligji.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi se, në bazë të Vendimit Qarkullues nr.8, datë 03.02.2020 “Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën

e mjekësisë, për vitin akademik 2019 -2020, në Universitetit e Mjekësisë Tiranë” (në vijim Vendimi nr.8/2020, i Senatit Akademik të UMT), janë miratuar 296 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) kuota, nga të cilat 113 kuota pranimi të mbuluara nga MSHMS, 18 kuota për MM, 11 kuota për MD, 1 kuotë për MB dhe 153 kuota të lira. Kuotat e pranimit përcaktohen nga UMT, pas një procesi konsultimi dhe propozimeve të paraqitura nga ministrinë.

Në pikën 8, të vendimit të sipërcituar, përcaktohet si vijon: “ *Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara sipas pikës 1/a),b),c) dhe d) të këtij vendimi duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse. Studentët e shpallur fitues në kuotat sipas pikës 1/a),b),c) dhe d) të këtij vendimi lidhin kontratën me ministrinë përkatëse. Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj, detyrimet, penalitetet në rast mosrespektimi të tyre, është përgjegjësi e ministrive përkatëse, të cilat kanë dhe detyrimin e njoftimit të kandidatit lidhur me këtë aspekt, para hapjes së procesit të aplikimeve”*

Bazuar në aktet e administruara, rezulton se, kuotat e akorduara për MM janë plotësuar me 1 personel ushtarak (sipas urdhrit të MM nr.857, datë 23.07.2020) dhe 1 personel civil (sipas urdhrit të MM nr.858, datë 23.7.2020), nga radhët e forcave të armatosura, si dhe 15 personel civil jashtë radhëve të forcave të armatosura (sipas urdhrit të MM nr. 859, datë 23.7.2020).

Me urdhërin nr.856, datë 23.07.2020 “Për miratimin e kontratës “Për ndjekjen e studimeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë nga personeli ushtarak dhe civil i forcave të armatosura dhe civilët jashtë radhëve të forcave të armatosura”, të Ministrisë të Mbrojtjes, janë miratuar 3 modele kontratash, respektivisht për personelin ushtarak të forcave të armatosura, personelin civil të forcave të armatosura dhe për kategorinë e civilëve jashtë radhëve të forcave të armatosura. Referuar modeleve të kontratave të miratuara sipas urdhrit të sipërcituar, rezulton se, MM garanton trajtim financiar për dy kategoritë e para të studentëve specializantë që vijnë nga radhët e forcave të armatosura (neni 4, pika 3 e kontratës), ndërsa nuk garanton asnjë mbështetje financiare për studentët jashtë radhëve të forcave të armatosura (neni 4, pika 3 e kontratës).

Nga tërësia e akteve të administruara dhe parashtrimeve të dhëna nga MM, trajtimi financiar për dy kategoritë e specializantëve që vijnë nga radhët e FA është si më poshtë:

- Kategoria e specializantëve, të cilët vijnë nga radhët e personelit ushtarak të forcave të armatosura, trajtohet financiarisht sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 26, të ligjit 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilën parashikohet: “1. Ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist), për periudhën e arsimimit, të trajnimit ose të kualifikimit në kurse, shkolla të larta ushtarake (akademi) ose universitete, brenda dhe jashtë vendit, përfiton pagë dhe kompensime si më poshtë: a) për periudha arsimimi, trajnimi ose kualifikimi në kurse dhe shkolla të larta ushtarake (akademi) ose universitete brenda vendit pagën e plotë mujore, së bashku me të gjitha kompensimet;”

- Kategoria e specialistëve të cilët vijnë nga radhët e personelit civil të forcave të armatosura, trajtohet financiarisht sipas pikës 11, të VKM nr.555, datë 11.8.2011 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në Strukturat e Forcave të Armatosura”*, të ndryshuar. (në vijim VKM nr.555/2011)⁵, në të cilën parashikohet: *“11. Mjekët e sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe mjekët civilë të strukturave të Forcave të Armatosura, të cilët kryejnë specializimin në qendrat spitalore universitare, gjatë kohës së specializimit, të paguhen në masën 80 për qind të pagës së mjekut të fushës në të cilën kryhet specializimi.”*
- Ankuesja, e cila është personel civil jashtë radhëve të forcave të armatosura, pavarësisht se ka përfituar të drejtën e ndjekjes së studimeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë nga kuotat e MM, në bazë të kontratës së lidhur me MM, nuk përfiton asnjë trajtim financiar nga ana e kësaj të fundit. Për kategorinë e specialistëve të cilët janë personel civil jashtë radhëve të FA, sikurse ankuesja, MM, nuk ka dhënë asnjë shpjegim se përse ata nuk përfitojnë mbështetje financiare gjatë ndjekjes së specializimit në fushën e mjekësisë, si përfitues të kuotave të akorduara për këtë ministri me vendimin e Senatit Akademik të UMT.

Komisioneri konstaton se, fakti që ankuesja nuk trajtohet financiarisht gjatë ndjekjes së specializimit në fushën e mjekësisë, e drejtë e fituar nga kuotat e akorduara për MM, bie në kundërshtim me bazën ligjore të vendosur në modelin e kontratës së miratuar me urdhër të MM si dhe kontratën e nënshkruar midis MM dhe ankuseses. Në nenin 2, të kontratës të nënshkruar midis palëve, referohet se kontrata ndër të tjera bazohet në VKM nr.555/2011, akt nënligjor, i cili në pikën 11, parashikon trajtim financiar për mjekët civilë të strukturave të Forcave të Armatosura, të cilët kryejnë specializimin në qendrat spitalore universitare, gjatë kohës së specializimit, të paguhen në masën 80 për qind të pagës së mjekut të fushës në të cilën kryhet specializimi.

Sa më sipër rezulton qartë se ankuesja, e cila ndjek specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë me kuota nga MM, por që nuk vjen nga radhët e FA, trajtohet në mënyrë të diferencuar dhe më pak të favorshme, pasi nuk përfiton asnjë trajtim financiar gjatë periudhës që ndjek specializimin, në raport me studentët specialistë, të cilët po ashtu mbulohej me kuota nga MM, por vijnë nga radhët e FA, përfshi këtu personelin ushtarak dhe personelin civil, të cilët përfitojnë trajtim financiar gjatë ndjekjes së specializimit.

⁵ Me VKM nr. 1076, datë 24.12.2020, emërtimi i VKM nr.555/2011 ka ndryshuar si vijon: *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”*

Diferenca në trajtim dhe trajtimi më pak i favorshëm duhet të konsistojë në dy situata të njëjta ose të ngjashme. Në kuadër të diskriminimit të drejtpërdrejtë të parashikuar nga neni 3, pika 3, të LMD, nuk mund të pretendohet diferencë në trajtim ose trajtim më pak i favorshëm për dy situata që nuk janë të njëjta ose të ngjashme. Për rrjedhojë çështja që shtrohet në vijim është, nëse ankuesja ndodhet në një situatë të njëjtë ose të ngjashme me studentët, të cilët ndjekin specializimin me kuota nga MM, por që ndryshe nga ankuesja që nuk vjen nga radhët e FA, ky grupim vjen nga radhët e FA.

Në bazë të nenit 77/1/3, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” programet e studimeve specializuese afatgjata, përfshihen në ciklin e tretë të studimeve dhe janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta.

Sipas Statutit të UMT, në nenin 88/1/b dhe 8/3 përcaktohet: “ 1. *Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve:b) Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë.....3. Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional, që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se 2 (dy) vite akadenrike dhe organizohen me jo më pak se 120 kreditë. Ato përmbyllet me provim formimi dhe me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë specializimi” në fushën përkatëse të programit të studimit.”*

Ndjekja e studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, rregullohet sipas Rregullores së Studimeve të Specializimeve Afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, e cila është miratuar me vendimin nr.88, datë 16.11.2016, të Senatit Akademik, të UMT, me ndryshimet përkatëse. Referuar përcaktimeve të bëra në këtë rregullore si dhe në përgjigjen e dërguar nga UMT, nuk ka asnjë ndryshim midis studentëve që ndjekin specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, në varësi të faktit nëse mbulohen apo jo nga kuotat e ndonjë ministrie apo nëse ndjekin studimet në bazë të kuotave të lira. Të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj rregullore për të përfunduar specializimin dhe për t’u pajisur me “Diplomën e specializimit” janë të njëjta.

Rregullorja e Specializimeve, parashikon diferenca midis kuotave të lira dhe atyre të mbuluara nga ministrinë, duke vendosur detyrimin që, ata që duan të përfitojnë nga kuotat e ministrive duhet të paraqesin në momentin e aplikimit një letër mbështetëse nga ana e ministrisë ku duan të përfituanë kuotën (Shtojca nr.2, e Rregullores). Në këtë mënyrë që në momentin e aplikimit, midis ankuses dhe MM, është vendosur një marrëdhënie e ndërsjelltë. Ankuesja nëpërmjet deklaramit të vullnetit për të aplikuar në kuadër të kuotave të mbuluara nga MM dhe për të cilat kjo e fundit ka shprehur nevojën dhe interesin, dhe nga ana tjetër MM, e cila nëpërmjet letrës mbështetëse ka shprehur vullnetin dhe mbështetjen ndaj ankuses.

Në nenet 6, 8 dhe 45, të Rregullores së Specializimeve, përcaktohet se:

“ Neni 6

Për specializantët që kanë përfituar nga kuotat e mbuluara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë apo nga Ministri të tjera, marrëdhëniet kontraktuale financiare lidhen mes specializantit dhe Ministrisë përkatëse. Për shpërblimin e rojeve 24-orëshe, mjeku specializant do të përfitojë shpërblim financiar sipas akteve nënligjore të strukturave pjesë e rrjetit formues përkatës.

Neni 8

Në përfundim të specializimit afatgjatë, mjeku i specializuar që ka përfituar nga kuotat e mbuluara nga Ministrinë përkatëse, ka detyrimin të zbatojë të gjitha kushtet e parashikuara në kontratat e lidhura paraprakisht me palët në momentin e regjistrimit në programin specializues. Kontrata miratohet me urdhër/udhëzim të Ministrisë të Ministrisë përkatëse. Në rast mosrespektimi të kontratës, mjeku i specializuar paguan penalitetet përkatëse, si dhe shlyen detyrime të tjera, sipas përcaktimeve të bëra në kontratë.”

Neni 45

Kandidati përfitues i kuotave të mbuluara nga ministria përkatëse, duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me ministrinë përkatëse, jo më vonë se 2 (dy) javë nga data e regjistrimit.”

Regjistrimi përfundimtar i ankueses për ndjekjen e specializimit afatgjatë, si fituese që mbulohet nga kuotat e MM, kushtëzohet nga nënshkrimi dhe paraqitja e kontratës së nënshkruar me MM. Neni 6, i Rregullores së Specializimeve, në mënyrë të shprehur parashikon se, midis specializantit dhe ministrisë që mbulon me kuotë specializantit lidhet një marrëdhënie kontraktuale financiare. Në rastin e specializantëve, të cilët vijnë nga radhët e FA, marrëdhënia kontraktuale e nënshkruar midis tyre dhe MM, ka parashikime të natyrës financiare, pasi për këtë kategori parashikohet e drejta për t’u trajtuar financiarisht sipas parashikimeve respektive të përcaktuara në kontratë. Në rastin e ankueses, e cila nuk bën pjesë në radhët e forcave të armatosura, marrëdhënia kontraktuale e nënshkruar midis saj dhe MM, nuk ka asnjë parashikim apo rregullim të natyrës financiare, pasi për ankuesen që nuk vjen nga radhët e forcave të armatosura, nuk parashikohet asnjë trajtim financiar gjatë kohës që ajo ndjek specializimet afatgjata, me kuota të mbuluara nga MM dhe për interes të kësaj të fundit.

Në nenin 1, të Rregullores së Specializimeve, përcaktohet: “*Programi i specializimit afatgjatë, përfshin formim të karakterit teorik dhe praktik në fushën e specialitetit përkatës, i cili realizohet në strukturat universitare të Universitetit Mjekësisë, Tiranë (UMT), në strukturat spitalore të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUT) dhe qendra të tjera spitalore universitare, si dhe në struktura të tjera të akredituara dhe aprovuara për këtë qëllim nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për arsimin, konform standardeve shtetërore të cilësisë për specializimet afatgjata në Mjekësi, që do të bëhen pjesë e rrjetit formues, me të cilat UMT do të lidhë marreveshjet përkatëse paraprakisht në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.”*

Në nenin 3, të Rregullores së Specializimeve, përcaktohet: *“Programi i studimeve të specializimit afatgjatë, kryhet me kohë të plotë pranë strukturave të rrjetit formues ku është përcaktuar të kryhet specializimi, në përputhje me programin përkatës të specializimit, procedurat e përcaktuara, si dhe nën mbikëqjen e personave dhe autoritetit apo entit përgjegjës.....”*

Ndjekja e programit të studimit të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë kryhet me kohë të plotë dhe me shkëputje nga nga puna. Në këtë kontekst, rezulton se MM, me urdhrin nr.857 datë 23.7.2020 dhe urdhrin nr.858, datë 23.7.2020, ka udhëruar lirim nga detyra, respektivisht për personelin ushtarak dhe civil nga radhët e FA që kanë përfituar nga kuotat e mbuluara nga MM, për vitin akademik 2019-2020. Për rrjedhojë gjatë ndjekjes së specializimit, specializantët, pavarësisht se vijnë nga radhët e FA, ashtu sikurse ankuesja, e cila nuk vjen nga radhët e FA, nuk janë në marrëdhënie pune me MM.

Të drejtat dhe detyrimet e specializantëve, të cilët ndjekin specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë janë të njëjta, ndjekja e studimeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë është me kohë të plotë dhe me shkëputje nga puna. Të dy kategoritë, si specializantët që vijnë nga radhët e FA ashtu edhe specializantët që nuk vijnë nga radhët e FA, janë shpallur fitues për ndjekjen e studimeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë nga kuotat e mbuluara nga MM. Rregullorja e Specializimeve, e cila rregullon ndjekjen e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, nuk vendos ndonjë diferencë në trajtim për kategori të caktuara specializantësh brenda kuotave të mbuluara nga ministri të caktuara, përfishi këtu MM.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesja si pjesë e kategorisë së studentëve specializantë, jashtë radhëve të Forcave të Armatosura, është në kushte të ngjashme me kategorinë e studentëve specializantë të cilët vijnë nga radhët e Forcave të Armatosura, gjatë ndjekjes së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në kuadër të kuotave të mbuluara nga MM.

Sikurse përcaktohet nga kuadri i mësipërm ligjor dhe nënligjor, studimet afatgjata në fushën e mjekësisë, janë programe të studimeve specializuese afatgjata, të cilat përfshihen në ciklin e tretë të studimeve të arsimit të lartë dhe janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta.

Në bazë të nenit 5, të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 *“Për profesionet e rregulluara në republikën e shqipërisë”*, profesioni i mjekut, është një profesion i rregulluar. Referuar nenit 4, të ligjit të sipërcituar, "Profesion i rregulluar" është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. Po sipas këtij ligji (neni 4), "Kualifikimet profesionale"

janë kualifikimet e certifikuara me një titull studimi, një dëshmi aftësie ose një përvojë profesionale.

Në rastin objekt shqyrtimi, në përfundim në programit të studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, ankuesja përfiton “Diplomë Specializimi” në specialitetin “kirurgji plastike”, që është një dokument zyrtar që certifikon përfundimin e formimit të saj profesional. Pa këtë dokument zyrtar “diplomë specializimi” në specialitetin “kirurgji plastike”, ankuesja nuk mund të ketë akses dhe të ushtrojë profesionin e mjekut në këtë specialitet, pasi ushtrimi i tij kushtëzohet nga një nivel i caktuar formimi që certifikohet nëpërmjet “diplomës së specializimit” në specialitetin “kirurgji plastike”.

Bazuar në kontratën e nënshkruar (neni 1) midis MM dhe ankueses, rezulton se, objekti i kësaj kontrate është ndjekja e programit të ciklit të tretë të studimeve aftagjata në fushën e mjekësisë, për nevojat dhe në interes të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe shërbimi në Forcat e Armatosura, sipas nevojave dhe specializimit të kryer. Në nenin 4, pika 5 të kontratës, MM, pas përfundimit të specializimit, i krijon mundësinë e punësimit, në strukturat shëndetësore të FA-së, në varësi të nevojave dhe specializimit përkatës të kryer. Në këtë mënyrë, ankuesja dhe MM, kanë hyrë në një marrëdhënie të ndërsjelltë, ku ankuesja pranon të ndjekë specializimet për nevojat e MM, ndërsa kjo e fundit angazhohet që në përfundim të specializimit të mundësojë punësimin e ankueses në strukturat e saj shëndetësore, në varësi të nevojave.

Rregullorja e Specializimeve, përveç kuadrit ligjor të posacëm që i përket fushës së arsimit të lartë, bazohet edhe në Kodin e Punës.

Në nenin 3, të Rregullores së Specializimeve, përcaktohet: *“.....Mjeku specializant vepron konform kësaj rregullore dhe programit përkatës specializues, si dhe rregullave të strukturës në të cilën ndjek programin përkatës. Specializanti angazhohet me kohë të plotë për 40 orë në javë, pranë strukturave ku është përcaktuar të ndjeke programin specializues dhe ka detyrimin e kryerjes e të paktën 24 rojeve klinike në vit, nën mbikëqyrjen për ato programe specializuese që parashikojnë roje duke filluar që nga viti i parë. Përfshirja në aktivitetin kliniko-profesional fillon që me fillimin e programit të studimit të specializimeve afatgjata.*

Në nenin 4, të Rregullores së Specializimeve, përcaktohet: *“Specializanti duhet të marrë gjatë periudhës së specializimit njohuri teorike dhe praktike, të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të tij si mjek i specializuar, në mënyrë të pavarur në përfundim të specializimit afatgjatë, në fushën e trajtimit, diagnostikimit dhe parandalimit të patologjiive. Për realizimin e sa më sipër ai ushtrohet gjatë periudhës së specializimit në mënyrë të pavarur por nën mbikëqyrjen e pedagogëve, mjekëve specialistë, udhëheqësve klinikë dhe tutorëve, të cilët e ndjekin specializantin gjatë punës së tij.”*

Sa më sipër, rezulton se gjatë periudhës së specializimit, specialistët ushtrojnë funksionet e tyre si mjekë, në mënyrë të pavarur edhe pse nën mbikëqyrjen e personave të tjerë përgjegjës. Specialisti ushtrohet me kohë të plotë prej 40 orë në javë, pranë strukturës përkatëse ku ushtrion në praktikë funksionet e tij, që i korrespondon kohëzgjatjes javore të punës të parashikuar nga Kodi i Punës. Për më tepër, specialisti ka detyrimin që *të kryejë të paktën 24 roje klinike në vit, çka do të thotë se ata kryejnë edhe punë nate.*

Pavarësisht se nuk ka një detyrim taksativ për MM për punësimin e ankueses në përfundim të specializimit, palët kanë hyrë në një marrëdhënie të tillë ku ankuesja ka vendosur të formohet profesionalisht në specialitetin “kirurgji plastike” në funksion të intersit dhe nevojave të MM dhe më qëllimin për t’u punësuar pranë MM.

Në përfundim të gjithë sa më sipër është konstatuar, rezulton që, specialistët, pavarësisht kategorive që i përkasin, kanë të njëjtat detyrime akademike dhe klinike, pra praktikisht kryejnë të gjithë të njëjtën punë, për të cilën rezulton se, disa paguhen dhe disa të tjerë jo.

Në Kreun II, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD, në nenin 12/1/c, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, *bazuar në çdo shkak të mbrojtur nga neni 1, i këtij ligji, duke përcaktuar shprehimisht se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;*

Kodi i Punës, në nenin 9, pika 1, parashikon : “ 1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”. Në pikën 5, të po këtij neni, Kodi i Punës, parashikon: “5. Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: b) qasjen në të gjitha llojet dhe në të gjitha nivelet e orientimit profesional, trajnimit profesional, trajnimit dhe ritajnimit të avancuar profesional, përfshirë edhe përvojën e punës në praktikë; c) kushtet e punës dhe punësimin, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën;.... ”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, marrëdhënia kontraktore e lidhur midis MM dhe ankueses, është një marrëdhënie, e cila hyn në fushën e marrëdhënieve të punës dhe për rrjedhojë, pretendimi i ankueses se është viktimë e diskriminimit, do të trajtohet në kuadër të pretendimeve për diskriminim në fushën e punësimit.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja K.F, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, duke mos përfitur asnjë trajtim financiar gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, për shkak se nuk vjen nga radhët e Forcave të Armatosura, në raport me specializantët të cilët vijnë nga radhët e Forcave të Armatosura, për të cilët Ministria e Mbrojtjes garanton trajtim financiar gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Ankuesja K.F, pretendon diskriminim, për shkak të *gjendjes ekonomike*, nga ana e MM.

Bazuar në nenin 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikohet se: “***Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.***”

Në referencë të kësaj dispozite ligjore, rezulton se shkaku i pretenduar nga ankuesja, *gjendja ekonomike*, është shkaku i mbrojtur, i parashikuara shprehimisht nga ligji, ndërkohë që nga ana tjetër, lista e shkaqeve të mbrojtura të cituara shprehimisht në këtë nen, është një listë orientuese dhe jo shteruese.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të *gjendjes ekonomike*, ankuesja e bazon këtë pretendim në faktin se, sjellja e kundërshtuar, haptazi diskriminon studentët që vijnë nga familje që nuk kanë shumë mjete financiare në dispozicion, pra që janë të varfër kundrejt atyre që janë të pasur. Kjo sipas ankueses, presupozon që një person në moshën 25 vjeçare të jetë akoma barrë dhe përgjegjësi për prindërit apo të afërmit dhe qartazi ata njerëz nuk e kanë këtë mundësi, nuk mund të specializohen, pasi nuk kanë si të ushqehen.

Në lidhje me shkaku të pretenduar të diskriminimit nga ana e ankueses, Komisioneri thekson se, *gjendja ekonomike* si shkaku i ndaluar diskriminimi është një koncept i gjerë. *Shkaku i gjendjes ekonomike*, i referohet kryesisht situatës aktuale të një personi për sa i përket pasurisë, pronës, apo karakteristikave të tjera të ngjashme dhe që mund të ndryshojnë gjatë rrjedhës së jetës së një personi. *Gjendja ekonomike*, si shkaku i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton në shumë fusha të jetës, në pamundësi shoqërore, arsimore, intelektuale, materiale, kulturore deri dhe ekzistenciale. Komenti

i Përgjithshëm nr.20 “Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, i Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara, parashikon : *“Situata sociale dhe ekonomike e një personi kur jeton në varfëri ose është i pastrehë mund të rezultojë në diskriminim të përhapur, stigmatizim dhe stereotipe negative që mund të çojnë në refuzimin ose aksesin e pabarabartë për të njëjtën cilësi të arsimit dhe kujdesit shëndetësor si të tjerët, si dhe mohim ose akses të pabarabartë në vendet publike”*

Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi si dhe provat e administruara, Komisioneri nuk konstaton diferencë në trajtimin e ankueses gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, e cila bazohet në gjendjen e saj ekonomike. Pavarësisht se ankuesja pretendon se trajtimi i pabarabartë dhe i pafavorshëm të cilit i është nënshtruar vjen për shkak të gjendjes ekonomike, ajo nuk arriti të provojë gjendjen e saj ekonomike dhe se si kjo gjendje cënon ankuesen në të drejtat e pretenduara prej saj.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se shkakun e gjendjes ekonomike, nuk rezultoi i provuar dhe është i pabazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës.

Në nenin 77, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet parimi i hetimit kryesisht nga ana e oragnit administrativ. Në pikën 1 e 2 të dispozitës së sipërcituar, parashikohet: *“ 1. Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.”*

Komisioneri, sikurse më sipër është arsyetuar, ka konstatuar se ankuesja K.F, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, duke mos përfitur asnjë trajtim financiar gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, për shkak se nuk vjen nga radhët e Forcave të Armatosura, në raport me specializantët të cilët vijnë nga radhët e Forcave të Armatosura, për të cilët Ministria e Mbrojtjes garanton trajtim financiar gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë. Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi, parashtrimet dhe pretendimet e ankueses të marra në tërësinë e tyre, pavarësisht identifikimit të bërë nga ana e palës ankuese lidhur me shkakun e pretenduar të diskriminimit, Komisioneri konstaton se, diferenca në trajtim të cilës i është nënshtruar ankuesja, ka si shkak faktin se ankuesja nuk është pjesë e FA/ nuk vjen nga radhët e FA.

Duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që LMD, bën në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas LMD, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Për të vlerësuar nëse një shkak i ndaluar/mbrojtur diskriminimi gëzon mbrojtje nga parashikimi “për çdo shkak tjetër”, Komisioneri do të mbajë në konsideratë praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut⁶, në drejtim të interpretimit të shkaqeve/statuseve të tjera sipas nenit 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut⁷.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “*statuse të tjera*”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, objektive ose personale, ose “*status*”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.⁸ Gjykata ka theksuar se fjalës “*shkak/status tjetër*” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.⁹ Interpretimi i këtij nocioni “nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të natyrshme”¹⁰.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “*statuseve të tjera*” janë: Në *Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta*, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në *gradën ushtarake* mund të binte në kundërshtim me nenin 14; Në *Larkos kundër Qipros*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një *dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër*; Në *Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konsideroi se të qenit *i burgosur* mund të binte në nocionin e “*statusit tjetër*” sipas nenit 14; Në *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “*statusit tjetër*”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se *statusi si ish oficer i KGB-së* përfshihet në nenin 14; Në *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e lirimimit të parakohshëm midis *personave që vuanin dënime afatgjata të përcaktuar me 15 vjet ose më shumë dhe atyre që vuanin dënime afatgjata të përcaktuar me më pak se 15 vjet ose dënime të papërcaktuara*.

Në çështjen *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar* (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha

⁶ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën GJEDNJ.

⁷ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KEDNJ.

⁸ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

⁹ Shiko: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

¹⁰ Shiko: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”

Komisioneri gjithashtu në praktikën e tij ka konstatuar diskriminim si rezultat i trajtimit diferencues dhe më pak të favorshëm midis grupit të punonjësve të administratës dhe grupit të punonjësve të terrenit¹¹, në lidhje me reduktimin e pagës midis këtyre kategorive të ndryshme të punonjësve.

Duke u bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, diferenca në trajtim midis ankueses si specializante jashtë radhëve të FA dhe specializantëve që vijnë nga radhët e FA/pjesë e FA, gëzon mbrojtje në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”, sipas parashikimit të nenit 1 të LMD dhe mund të vijë në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, të mbrojtur dhe të rregulluar nga dispozitat e LMD. Komisioneri vlerëson se, ekzistojnë prova të mjaftueshme të cilat tregojnë se ankuesja e mbart shkakun e mbrojtur.

B. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Nga shqyrtimi i fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se, ankuesja K.F, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, duke mos përfitur asnjë trajtim financiar gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, për shkak se nuk vjen nga radhët e Forcave të Armatosura, në raport me specializantët të cilët vijnë nga radhët e Forcave të Armatosura, për të cilët Ministria e Mbrojtjes garanton trajtim financiar gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë.

Shqyrtimi i pretendimeve, nëse trajtimi i pabarabartë dhe i pafavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja, përbën diskriminim, do të bazohet në kuadrin e mëposhtëm ligjor.

Neni 18, i Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e parazisë dhe mosdiskriminimit, sanksionon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”.

LMD, është një ligj i cili është miratuar mbështetur dhe në zbatim të dispozitës së mësipërme kushtetuese.

11 Shiko: *Sindikata e Re e Naftëtarëve Shqiptar kundër Albpetrol sh.a*, Vendimi nr.107, datë 11.09.2020, i Komisionerit.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹².

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, interpreton: *“E drejta për punë që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetues, është një e drejtë e individit në sensin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme, fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkupton çdo veprimtari të ligjshme që sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasojat të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale, përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që i jep Kushtetuta individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit, ka si qëllim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Liria*

¹² Shiko: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

e profesionit nuk është thjeshtë një e drejtë për të patur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit, gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që i bën neni 49 i Kushtetutës të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë. Në këtë mënyrë e trajton të drejtën për punë edhe doktrina kushtetuese, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.”

KEDNJ-ja, nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga GJEDNJ-ja si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “*gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji*” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në nenin 5, të LMD parashikohet se : “*1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.*”

Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : “*7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.*” Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit në punësim dhe profesion e bën edhe Kodi i Punës, duke sanksionuar në nenin 9, pika 10, të tij se: “*10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë*”, si dhe Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon : “*2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të*

presumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminim.¹³

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në kushtet, kur, Komisioneri ka arritur në përfundimin se, ankuesja K.F, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm, diferencë kjo e cila bazohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë në faktin se ankuesja nuk është pjesë e FA, rezulton e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm. Në këto kushte, mbetet që të vlerësohet nëse për këtë diferencë në trajtim ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Ekzistenca e një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, Komisioneri konstaton se, brenda kategorisë së specializantëve që vijnë nga radhët e FA, konstatohen dy nënkategori. Konkretisht specializantët që kanë statusin e ushtarakut dhe specializantët që janë personel civil.

¹³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

Rezulton se, trajtimi financiar që përfitojnë specialistët që kanë statusin e ushtarakut gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, është një e drejtë që buron nga ligji nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Trajtimi financiar që ata përfitojnë gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, është ngushtësisht i lidhur me statusin që ata gëzojnë si ushtarak. Në bazë të nenit 3, të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004, shërbimi ushtarak është veprimtari e veçantë, shoqërisht e domosdoshme për shtetin. Masa e trajtimit financiar që përfitojnë specialistët që janë personel ushtarak pjesë e FA, përllogaritet në raport me pagën mujore që ata përfitojnë për shkak të statusit si ushtarakë, pa humbur gjatë kësaj periudhe asnjë kompesim që buron nga ky status.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, diferenca në trajtim midis ankueses, e cila nuk është pjesë e FA dhe specialistëve të cilët jënë pjesë e FA si personel ushtarak, justifikohet në mënyrë objektive dhe të arsyeshme, për shkak të statusit të veçantë të ushtarakut të akorduar me ligj dhe natyrës së veçantë të shërbimit ushtarak.

Ndërkohë, trajtimi financiar që përfiton kategoria tjetër e specialistëve që vijnë nga radhët e FA, por janë personel civil (nuk gëzojnë statusin e ushtarakut), përfitohet në bazë të VKM-së nr.555/2011. Kjo kategori nuk është përfituese e trajtimit financiar si pasojë e një të drejte të akorduar me ligj. Të drejtat dhe detyrimet e specialistëve të cilët ndjekin specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë janë të njëjta dhe ndjekja e studimeve është me kohë të plotë dhe me shkëputje nga puna. Të dy kategoritë, si specialistët që vijnë nga radhët e personelit civil të FA ashtu edhe specialistët civilë jashtë radhëve të FA, janë përfitues të kuotave për ndjekjen e studimeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë nga kuotat e mbuluara nga MM.

Referuar kontratës së nënshkruar midis ankueses dhe MM, ndër të tjera, rezulton se, marrëdhënia midis ankueses, e cila nuk është pjesë e FA, rregullohet në bazë të të njëjtit akt, VKM-së nr.555/2011, mbi bazën e të cilit trajtohen edhe specialistët që janë personel civil, pjesë e FA. MM, nuk ofroi asnjë shpjegim se përse nuk ka zbatuar parashikimin e VKM nr.555/2011, lidhur me trajtimin financiar për ankuesen, si pjesë e kategorisë së specialistëve civilë jashtë radhëve të FA dhe nuk ngriti pretendime në lidhje me moszbatimin e aktit të sipërshtuar për rastin e ankueses.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, MM, prapësoi se, në momentin e aplikimit për kuotat e mbuluara nga MM, të gjithë aplikantët kanë qenë në dijeni të faktit se para fillimit të studimeve duhet të nënshkruanin një kontratë me MM, në të cilën përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve. Komisioneri dakortëson se një fakt i tillë është i bazuar dhe në bazë të Rregullores së Specializimeve, akteve të organeve të UMT si dhe dokumentacionit që specialistët dorëzojnë në momentin e aplikimit, rezulton plotësisht e qartë se specialistët kanë plotësisht dijeni për faktin se duhet të nënshkruajnë një kontratë me ministrinë përkatëse, nga kuotat e të cilës kanë

fituar të drejtën për ndjekjen e specializimit, nëpërmjet të cilës do të rregullohen detyrimet midis palëve.

Më tej, në referim të pikës 8, të vendimit nr.8/2020, të Senatit Akademik të UMT, parashikohet se: “Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj, detyrimet, penalitetet në rast mosrespektimi të tyre, është përgjegjësi e ministrive përkatëse, të cilat kanë dhe detyrimin e njoftimit të kandidatit lidhur me këtë aspekt, para hapjes së procesit të aplikimeve”. Në bazë të akteve të administruara rezulton se, MM, ka miratuar modelin e kontratës, ku përcaktohen edhe detyrimet apo penalitetet, me urdhrin nr.856, datë 23.07.2020, të Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa kontrata midis ankueses dhe MM është lidhur në datën 24.7.2020. Bazuar në udhëzimin nr.2, datë 3.2.2020 “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e specializimeve aftgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2019-2020”, të Rektorit të UMT, aplikimet kanë qenë të hapura nga data 10.02.2020 deri në datën 22.02.2020. Sa më sipër dhe bazuar në aktet e administruara, nuk rezulton që ankuesja ka patur dijeni në lidhje me modalitete dhe detyrimet kontraktore para hapjes së procesit të aplikimeve, sikurse parashikohet në vendimin nr.8/2020, të Senatit Akademik të UMT.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, MM, propësoi se, ankuesja e ka firmosur kontratën model nr.3, me dëshirën e plotë të saj, pa asnjë kundërshtim dhe ka filluar studimet. Në lidhje me këtë pretendim të MM, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se kontrata përbën ligj midis palëve kontraktore, në rast se parashikimet e kësaj të fundit vijnë në kundërshtim me dispozitat të një shkalle më të lartë, ato janë të pavlefshme. Mbrojtja nga diskriminimi, është një e drejtë Kushtetuese dhe gëzon mbrojtje të posacme nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Në këtë kontekst, nëse konstatohet se, diferenca në trajtim të cilës i është nënshtruar ankuesja, për shkak se nuk është pjesë e FA, në raport me specialistët civil të cilët vijnë nga radhët e FA, përbën diskriminim, parashikimi kontraktor, është i pavlefshëm. Nga ana tjetër, konstatohet se, ankuesja ka qenë në kushtet e nënshkrimit të një kontrate kur tashmë ishte pranuar nga UMT si pjesë e kuotave të MM, pra ka qenë e kushtëzuar në një farë mënyre, pasi në kushtet e refuzimit të kontratës nga ana e ankueses, ajo humbiste të drejtën e fituar për të vazhduar specializimin.

Komisioneri konstaton se, nuk ka një kuadër rregullator në lidhje me trajtimin financiar të specialistëve gjatë ndjekjes së studimeve aftagjatë në fushën e mjekësisë. Rregullorja e Specializimeve Aftgjata në Fushën e Mjekësisë, në UMT, bazohet në dispozitat e Kodit të Punës, por nuk parashikon asnjë rregullim uniform në lidhje me trajtimin financiar të specialistëve, ndërsa vendos detyrimin për specialistët që të angazhohen me kohë të plotë për 40 orë në javë, pranë strukturave ku janë përcaktuar që të ndjekin programin specializues dhe detyrimin e kryerjes e të paktën 24 rojeve klinike në vit. Për specialistët që përfitojnë nga kuotat e mbuluara nga ministrinë përkatëse, rregulloja parashikon se detyrimet financiare midis specialistëve dhe ministrive parashikohen në kontratat përkatëse që lidhen midis specialistit

dhe ministrisë dhe që miratohen me urdhër të ministrit përkatës. Ndërsa për specializantët të cilët ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë, të cilët kanë të njëjta të drejta dhe detyrime në kuadër të procesit, nuk ka asnjë parashikim në lidhje me trajtimin e tyre financiar.

Bazuar në informacionin e administruar rezulton se, nuk ka uniformitet lidhur me trajtimin financiar të specializantëve të cilët ndjekin specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë me kuota të mbuluara nga ministritë përkatëse. Rezultoi se, vetëm MSHMS, ofron trajtim financiar për të gjithë specializantët e mbështetur me kuotata e saj dhe me të cilët ajo ka lidhur kontratat përkatëse. Trajtimi financiar bazohet në pikën 11, të VKM nr.555/2011 dhe kryhet nga ana e QSUNT, ku specializantët ndjekin programin e specializimit. Ministritë e tjera të cilave iu janë akorduar kuota bazuar në vendimin e Senatit Akademik të UMT, MD, MB dhe MD, nuk ofrojnë asnjë asnjë trajtim financiar për specializantët, të cilët ndjekin specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë me kuota të mbuluara nga këto ministri.

Në kushtet kur, ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e garantuar nga Kodi i Punës, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me ligji nr.10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime negative mbi çdo autoritet publik ose privat që krijon, ndryshon apo i jep fund një marrëdhënie të caktuar, të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e personave për mbrojtjen nga diskriminimi. Komisioneri vlerëson se, pavarësisht faktit se nuk ka një kuadër të përcaktuar ligjor ose nënligjor për trajtimin financiar të specializantëve gjatë kohës që ata ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë, në momentin që MM ofron trajtim financiar për studentët të cilët ndjekin specializimet me kuota të mbuluara nga MM, kjo e fundit ka detyrime negative për të mos cënuar të drejtën e personave për mbrojtje nga diskriminimi dhe që sjellja e saj të mos jetë diskriminuese.

Në këto kushte, Ministria e Mbrojtjes, nuk arriti të provojë se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të ankueses K.F, specializante nga radhët e civilëve jashtë Forcave të Armatosura, në raport me specizantët civilë të cilët vijnë nga radhët e Forcave të Armatosura, lidhur me trajtimin financiar gjatë ndjekjes së së specializimeve aftagjata në fushën e mjekësisë, me kuota nga Ministria Mbrojtjes.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Ministria e Mbrojtjes ka trajtuar në mënyrë të diferencuar, duke vendosur në kushte më pak të favorshme ankuesen K.F, specializante, e cila vjen nga nga radhët e civilëve që nuk janë pjesë e FA në raport me specializantët të cilët vijnë nga radhët e civilëve pjesë e FA dhe se një trajtim i tillë nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Komisioneri konstaton se, Ministria e Mbrojtjes, ka diskriminuar ankuesen K.F, për shkak se nuk vjen nga radhët e FA, duke shkelur parashikimet ligjore të nenit

3, pikat 1 dhe 2, nenin 5, pika 1 dhe nenin 12, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës, është marrja e masave nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, për të rivendosur në vend të drejtën e ankueses K.F, duke i njohur asaj të drejtën për trajtim financiar gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë. Ministria e Mbrojtjes duhet të rishikojë modelin 3, të kontratës “Për ndjekjen e studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë nga civilët jashtë radhëve të forcave të armatosura, të cilët kanë marrë mbështetjen për të aplikuar nga kuotat e Ministrisë së Mbrojtjes”, të miratuar me urdhrin nr.856, datë 23.07.2020 “Për miratimin e kontratës “Për ndjekjen e studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë nga personeli ushtarak dhe civil i Forcave të Armatosura dhe civilët jashtë radhëve të Forcave të Armatosura”, të Ministrit të Mbrojtjes, me qëllim eliminimin e diferencës në trajtim lidhur me trajtimin financiar të specializantëve civilë që nuk vijnë nga radhët e FA, të cilët ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë me kuota të mbuluara nga Ministria e Mbrojtjes, si dhe marrjen e masave që situata të tilla të mospërsëriten në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 32 e 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankueses K.F, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, për shkak të statusit si civil, jashtë radhëve të Forcave të Armatosura.
2. Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, Ministria e Mbrojtjes duhet të marrë masat e mëposhtme:
 - 2.1 Të rivendosë në vend të drejtën e cënuar, duke siguruar trajtim financiar për ankuesen K.F, gjatë ndjekjes së specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë në

specialitetin “kirurgji plastike”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, me kuota nga Ministria e Mbrojtjes.

2.2 Të rishikojë modelin 3, të kontratës “Për ndjekjen e studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë nga civilët jashtë radhëve të forcave të armatosura, të cilët kanë marrë mbështetjen për të aplikuar nga kuotat e Ministrisë së Mbrojtjes”, të miratuar me urdhrin nr.856, datë 23.07.2020 “Për miratimin e kontratës “Për ndjekjen e studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë nga personeli ushtarak dhe civil i Forcave të Armatosura dhe civilët jashtë radhëve të Forcave të Armatosura”, të Ministrit të Mbrojtjes, me qëllim eliminimin e diferencës në trajtim lidhur me trajtimin financiar të specializantëve civilë jashtë radhëve të FA, të cilët ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë me kuota nga Ministria e Mbrojtjes.

2.3 Të marrë masa për mos përsëritjen në të ardhmen të situatave të tilla diskriminuese.

3. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses K.F, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, për shkak të gjendjes ekonomike.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Ministria e Mbrojtjes, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku : Çdo shkak tjetër/Statusi civil jashtë Forcave të Armatosura
Fusha: Punësim
Lloji i Vendimit: Diskriminim